

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINE SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	--	---

Drejtoria e Arsimit
05 Nr.016-35415
Datë 23.06.2025

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, nenit 5, shkronja (b) të Ligjit për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës nr.03/L-068, Ligjit Nr.08/L-153 Për Edukimin në Fëmijëri në tërësi, nenit 4 paragrafi 8 të Udhëzimit Administrativ (MASHTI) NR.03/2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë, Drejtoria e Arsimit shpallë këtë:

K O N K U R S

Për regjistrimin e fëmijëve në IP "Fluturat" në Suharekë
Për vitin 2025/2026

Nr.	Emri i institucionit	Vendi	Grup-mosha	Nr. Fëmijëve
1	IP "Fluturat"	Suharekë	09-2 vjeç	7 fëmijë
		Duhël	3-5 vjeç	7 fëmijë
		Bukosh	3-5 vjeç	15 fëmijë
		Studençan	3-5 vjeç	13 fëmijë
		Samadraxhë	3-5 vjeç	15 fëmijë
		Mushtisht	3-5 vjeç	5 fëmijë
		Sopijë	3-5 vjeç	10 fëmijë
		Gjinoc	3-5 vjeç	7 fëmijë

Kriteret për regjistrimin e fëmijëve në IP "Fluturat"-Suharekë:

-Vetëm fëmijët e prindërve që janë banorë të Komunës së Suharekës mund të regjistrohen në IP "Fluturat"-Suharekë sipas zonës së mbulimit dhe sipas kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ (MASHTI) NR.03/2022 -PËR PËRFSHIRJEN E FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE NË KOSOVË.

Dokumentacioni i nevojshem per aplikim:

1. Aplikacioni (merret dhe dorëzohet në zyrët e IP"Fluturat" në Suharekë),
2. Dokumenti personal i prindit apo kujdestarit ligjor (leternjoftimi ose pasaporta kopje)
3. Ekstrakti i lindjes se femijës;
4. Certifikata e vendbanimit
5. Për qiramarrësit-kontrata mbi qiranë.
6. Dëshmia e mjekut për gjendjen shëndetësore të fëmijës;
7. Dëshmi për vaksinimin e fëmijës(fletorja e shëndetit të fëmijës);
8. Vërtetimi i punësimit të prindërve ose kontrata e punës (kopje);
9. Pasqyra e trustit për 6 mujorin e fundit.
10. Numri i fëmijëve tjerë të vendosur në institucionet parashkollore përkatëse.

Dokumentet dorëzohen në Institucionin Parashkollor "Fluturat" në Suharekë.

Dokumentet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen jashtë afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Konkursi është i hapur prej datës **24.06.2025** deri më date **08.07.2025**.

